

VENDIM
Nr.248, datë 31.3.2011

**PËR KALIMIN E SIPËRFAQES 4000 M², PRONË SHTETËRORE, NË FONDIN E
KOMPENSIMIT FIZIK DHE KOMPENSIMIN E KOMUNITETIT MYSLIMAN
SHQIPTAR, MYFTINIA KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11/a e 28 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në fondin e kompensimit fizik të truallit, pronë shtetërore, me sipërfaqe 4000 (katër mijë) m², të ndodhur në Korçë, në zonën kadastrale 8563, e përbërë nga prona me numër pasurie 4/41, sipas planit të rilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila, në përputhje me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, vihet në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pas verifikimit përfundimtar të pronësisë së truallit për fondin e mësipërm, e përdor atë për kompensimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar, myftinia Korçë, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Ngarkohen Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha